

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje karburanti

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): 09134100-8, VLERA E FONDIT LIMIT:

16.500.000 (gjashtembedhjetë milion e pesë qind mijë) leke pa tvsh.

Ne Euro / In Euro: 170,595.82 EUR, excluding VAT

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Rrogozhinë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas Shtojcës 9 të DST

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të tre viteve të fundit financiare, lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e parashikuar e kontratës. Në zbatim të nenit 43, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar mësipër. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa bazohet në nenin 77, pika 3 e Ligjit për Prokurimin Publik si dhe neni 43 I VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2022, 2023, 2024 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa bazohet në nenin 77, pika 3 e Ligjit për Prokurimin Publik si dhe neni 43 I VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", pika 4, Ligji nr. 29 / 2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Ligji Nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin Dhe Pasqyrat Financiare". Referuar nenit 61, pika 2 të Ligjit nr. 29 / 2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar "Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata."

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të kenë shlyer të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar).

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 40% e fondit** limit të kësaj kontrate. Për të provuar përvojën e mëparshme, duhet që:

a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten vërtetim i realizimit me sukses dhe faturën tatimore të shitjes të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten fatura tatimore të shitjes të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa bazohet në nenin 77 e Ligjit për Prokurimin Publik si dhe neni 40 I VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", pika 4. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e duhur e nevojshme për

të zbatuar kontratën object prokurimi. Për këtë arsye është kërkuar që furnizimet e mëpoarshme të ngjashme të jenë jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar nga neni I sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 1 (një) stacion të shitjes me pakicë në territorin e Bashkisë Rrogozhinë të vërtetuara me Niptin përkatës dhe të pasqyruara në Ekstraktin e shoqërisë. Stacione të shitjes me pakicë duhet të jenë të pajisura me autorizim për shitje karburantesh me pakicë, lëshuar nga Bashkia përkatëse ose në rastin e stacioneve të karburanteve të ndertuara në autostrada, nga ministri përgjegjës për transportin dhe leje mjedisore të tipit B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa bazohet në nenin 77, pika 2 e Ligjit “Për Prokurimin Publik” që thotë “Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë” si dhe neni 40 I VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 5, gërma a).

Kriteri është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor në zbatim të kërkesave që përcakton Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, Indryshuar. VKM Nr.147, datë 21.3.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diesel”, VKM Nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, Indryshuar, Ligji Nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Vendimi Nr. 429, datë 26.6.2019 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”, Urdhër Nr. 6, Datë. 09.01.2015 “Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifat përkatëse”, Indryshuar, Urdhër nr.315, datë 24.08.2017 “Për procedurat e lëshimit të vërtetimit Teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj” Ligji Nr. 52/2020

“Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “për Lejet e Mjedisit”, të ndryshuar.

Kërkesa për të disponuar të paktën 1 (një) stacion të shitjes me pakicë të në territorin e Bashkisë Rrogozhinë lidhet me shtrirjen e madhe territoriale të Bashkisë Rrogozhinë, prej rreth 200 km², numrin e konsiderueshëm të mjeteve në dispozicion, të shpërndara në të gjithë territorin e Bashkisë, për kryerjen e detyrave funksionale që kanë si dhe nevoja për ulje të konsumit të panevojshëm të karburantit për furnizimin e tyre me karburant.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Fletë Analiza të vlefshme, lëshuar nga ISHTI për produktin Naftë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa bazohet në nenin 77, pika 2 e Ligjit “Për Prokurimin Publik, si dhe neni 40, pika 6, gërma c , dhe neni 44 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

Gjithashtu kriteri është vendosur duke u bazuar në Ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, I ndryshuar. VKM Nr.147, datë 21.3.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diesel”. Kjo si nevojë e Autoritetit Kontraktor për tu garantuar në lidhje me karakteristikat teknike të mallit të ofruar të përputhen me standartet teknike të kërkuara.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim se nuk është penalizuar për cilësi jashtë standarteve të kërkuara nga legjislacioni Shqiptar gjatë vitit 2024-2025 , për stacionet që disponon. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Bazuar në nenin 77, pika 2 e Ligjit “Për Prokurimin Publik, si dhe neni 40, pika 6, gërma c , dhe neni 44 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik. Plotësimi I këtij kriteri garanton zbatimin e kontratës gjatë periudhës së zbatimit duke treguar operatorët ekonomikë ofertues zbaton rregullat dhe legjislacionin në fuqi, në aktivitetin e tij periodik.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë furnizimin me karburant me karta elektronike të vlefshme deri në përfundimin e plotë të kontratës. Operatori ekonomik duhet të ofrojë mundësinë e menaxhimit të karburantit në kohe reale (online) nga Autoriteti Kontraktor nëpërmjet një aplikacioni të vetin ose një webpage.

Argumentimi: Kriter I vendosur bazuan në Vendim Nr.561,date 29.7.2016 “ Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Operatorët ekonomikë, bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, paraqesin si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga Autoritetet Publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me nenin 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose

shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime te tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".